



OSHP "KLAN KOSOVA"

Baton Haxhiu

Drejtor

Prishtinë

Ankesa Nr. 2010/81 KPM v Klan Kosova

Ref: 1012/1398/KKPM/lxh

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2010/81-Komisioni i Pavarur për Media (KPM) kundër Klan Kosova ("Pala Përgjegjëse")

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media konform nenit 51 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të këtij Ligji, me anë të cilit përcaktohet sjellja e mediave gjate fushatës zgjedhore. KPM duke u bazuar në kapitullin VIII të këtij ligji, me datën 10 nëntor 2010 ka nxjerrë tre (3) udhëzues për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet.
2. Më datë 13 nëntor 2010 KPM, i ka dërguar Klan Kosovës tre (3) Udhëzues për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet Nr.03/L-073, (**Udhëzuesi 1-Identifikimi i reklamimit politik, Udhëzuesi 2-Raportimi për hulumtimin e opinionit publik lidhur me zgjedhjet, dhe Udhëzuesi 3-Periudha e heshtjes së mediave**). Qëllimi i dërgimit të këtyre udhëzuesve ka qenë që të licencuarve t'ju ofrojë udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore.
3. Me datë 1 dhjetor 2010 KPM për herë të dytë ju ka dërguar të gjitha subjekteve të licencuara nga KPM Udhëzuesin 3 (tre) të KPM-së që subjektet transmetuese të veprojnë në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e përgjithshme konkretisht me kreun VIII të këtij Ligji.
4. Gjithashtu me datë 9 dhjetor 2010 KPM për here të tretë, ju ka dërguar të gjitha subjekteve transmetuese dhe ofruesve të shërbimeve programore Udhëzuesin nr. 3 i cili përcakton se televizionet janë të obliguar t'i përmbahen nenit 52.1 të Ligjit për Zgjedhje, dhe Udhëzuesin nr. 3, me qëllim të parandalimit të shkeljeve gjatë heshtjes zgjedhore.
5. Divizioni i Monitorimit dhe Pajtueshmërisë së Mediave (DMPM) i KPM-së, gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore ka bërë monitorimin e subjekteve transmetuese dhe ofruesve të shërbimeve programore për të vlerësuar respektimin e Ligjit për zgjedhje dhe të tre (3) Udhëzuesve të KPM-së, dhe gjate monitorimit është konstatuar se ofruesi i shërbimeve programore "Klan Kosova" ka vepruar në kundërshtim me kreun VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në kundërshtim me Udhëzuesin Tre (3) të KPM-së.
6. Në bazë të raporteve të monitorimit është vërejtur se Pala Përgjegjëse gjatë "periudhës së heshtjes së mediave", e cila ka filluar të shtunën me 11 dhjetor 2010 në ora 7.00 dhe ka

Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Pristina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Priština

t. +381 (0)38 245 031 f. +381 (0)38 245 034 e. info@imc-ko.org

përfunduar të dielën më 12 dhjetor 2010, pas mbylljes së vendotimeve, ka transmetuar konferenca për shtyp të shtabeve zgjedhore të partive politike që kanë garuar në zgjedhje.

7. Gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, Pala Përgjegjëse, në emisionin "Maratona e Zgjedhjeve" ka transmetuar intervista të personaliteteve politike si në vijim: Arben Gashi, LDK, Qëndrim Gashi, FER, Memli Krasniqi, PDK, Arbër Geci, AKR. Gjithashtu Pala Përgjegjëse ka transmetuar drejtpërdrejt, nga Selia e Lëvizjes Vetëvendosje, ku shihet mbrapa slogani i këtij subjekti i cili ka garuar në zgjedhje, ndërsa nga AAK Besnik Tahiri nga shtabi i tyre zgjedhor. Po ashtu në prapavijë të te intervistuarve janë parë slogane të këtyre partive dhe mbishkrime të tjera që janë përdorur gjatë fushatës Zgjedhore.
8. Pas konstatimit të shkeljeve të bëra nga Pala Përgjegjëse KPM ka kontaktuar Palën Përgjegjëse përmes telefonit dhe ka kërkuar që të respektohet Ligji për Zgjedhjet respektivisht kapitulli VIII i Ligjit.
9. Duke u bazuar në monitorimin e vazhdueshme ndaj Palës Përgjegjëse dhe shkeljet e vazhdueshme të saj KPM me datë 12 dhjetor 2010 përmes e-mailit i ka tërhequr Vërejtjen Palës Përgjegjëse se është duke vepruar në kundërshtim me nenin 52.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë si dhe me Udhëzuesin nr. 3 të KPM-së. Mirëpo përsëri Pala Përgjegjëse ka vazhduar të transmetoi deklaratat e subjekteve të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhje si në vijim: "Lista Ibrahim Rugova", deklaratën e PDK-së, Frymës së Re, deklaratën e AKR-së, dhe deklarata të kandidatëve tjerë që kane garuar në zgjedhjet e përgjithshme si dhe intervista dhe deklarata nga shtabet zgjedhore të partive politike që garojnë në zgjedhje.
10. KPM ka konstatuar se Pala Përgjegjëse gjatë periudhës së heshtjes së mediave ka transmetuar programe televizive në kundërshtim me nenin 52.1 të Ligjit për Zgjedhje dhe Udhëzuesit tre (3) të KPM-së, i cili përcakton se televizionet janë të obliguar t'i përmbahen, nenit 52.1 të Ligjit për Zgjedhje i cili thekson se:

"Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve."
11. KPM duke u bazuar në raportin e monitorimit të datës 12 dhjetor 2010 ku është konstatuar shkelja e bërë nga ana e Palës Përgjegjëse më datën 12 dhjetor 2010, i ka dërguar Njoftim për Shkelje dhe ka kërkuar që Pala Përgjegjëse të vije në pajtueshmëri me ligjin për Zgjedhje si dhe me Udhëzuesin tre (3) të KPM-së.
12. Edhe pas pranimit të Njoftimit për Shkelje Pala Përgjegjëse përsëri ka vazhduar me shkelje duke publikuar programe të subjekteve politike të cilat kanë marrë pjesë në zgjedhje, prej të cilave ka marre deklarata të cilat i kanë takuar aktivitetit të fushatës zgjedhore, e që është në kundërshtim të plotë me nenin 52.1 të Ligjit për zgjedhje si dhe me Udhëzuesin tre (3) të KPM-së.
13. Këshilli i KPM-së ka sanksionuar me vërejtej Palën Përgjegjëse pasi që edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2009, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 52.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Udhëzuesin Nr. tre të KPM-së lidhur me "Periudhën e heshtjes së mediave". Pala Përgjegjëse është përgjigjur lidhur me shkeljen e bërë duke theksuar se KPM ka sjellur një Vendim të drejtë dhe ka kërkuar falje për shkeljet e bëra.
14. Pala Përgjegjëse po ashtu me datën 15 dhjetor 2010, ka bërë një reagim ndaj komunikatës së KPM-së në të cilën është potencuar se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Udhëzuesin Nr. tre të KPM-së, duke theksuar se ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 52 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Analiza Ligjore

15. Këshilli i KPM vlerëson që Pala Përgjegjëse, në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve më 12 dhjetor 2010, ka transmetuar programe në kundërshtim me nenin 52.1 të Ligjit për Zgjedhje dhe Udhëzuesin e KPM-së Nr. tre (3) duke transmetuar materiale të fushatës zgjedhore të subjekteve politike që kanë marrë pjesë në zgjedhje e përgjithshme.

Neni 52.1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton:

"Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve."

Gjithashtu në Udhëzuesin tre (3) përcaktohet se:

Në pajtim me praktikat e përgjithshme në Evropë, radiot dhe televizionet nuk duhet të transmetojnë asnjë deklaratë apo material tjetër që ka të bëjë me zgjedhjet, të ndonjë kandidati apo përfaqësuesi të një Entiteti Politik të Certifikuar, ose nga të tjerët në emër të ose të identifikuar lehtë me një kandidat apo Entitet Politik të Certifikuar.

Kjo ndalesë përfshinë transmetimin e deklaratave të kandidatëve që garojnë për zgjedhjet, transmetimin e çdo aktiviteti të subjektit politik të certifikuar dhe deklaratat e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore.

16. Pala Përgjegjëse edhe përkundër Udhëzuesit Nr. tre (3) të dërguar nga KPM për të vepruar në pajtueshmëri me Kapitullin VIII të Ligjit për Zgjedhjet, ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me Kapitullin VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme sepse me datën 12 dhjetor 2010, ka transmetuar materiale të fushatës zgjedhore të subjekteve politike të cilat kanë marrë pjesë në zgjedhje e përgjithshme.
17. Pala Përgjegjëse edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2009, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Udhëzuesin e KPM-së Nr. tre (3). Këshilli i KPM-së duke u bazuar në shkeljet e gjetura me datën 18 janar 2010 i ka leshur Vërejtje Palës Përgjegjëse për shkeljet e bëra. Mirëpo Pala Përgjegjëse edhe në zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010, ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë.
18. Këshilli i KPM-së bazuar në raportet e monitorimit konstaton se Pala Përgjegjëse, ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me kapitullin e VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Udhëzuesin Nr. tre (3) të KPM-së.
19. Këshilli i KPM -së si rrethana rënduese për Palën Përgjegjëse merr përsëritjen e shkeljeve të njëjta ku edhe pas kontakteve telefonike nga ana e zyrtarëve të KPM-së, e-mailit të KPM-së, Njoftimit për Shkelje, dhe Vendimit Sanksionues të datës 18 janar 2010 Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Udhëzuesin Nr. tre (3) të KPM-së.

Vendim

20. Këshilli i KPM-së bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konkludon se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (Nr. 03/L-073), respektivisht të nenit 52.1 të tij dhe Udhëzuesit Nr. tre (3) të KPM-së i cili përcakton rregullat për "Periudhën e heshtjes së mediave".

21. Këshilli i KPM-së, në bazë të nenit 20 pika c të Ligjit të KPM-së mori vendim që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me gjobë në shumë prej 20,000.00 euro, si dhe në bazë të pikës b Pala Përgjegjëse obligohet të kërkojë falje publike përmes programit të sajë për shkeljen e nenit 52.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Udhëzuesin tre (3), të KPM-së.

E drejta për Ankesë


22. Në pajtim me nenin 21.3 të Ligjit të KPM-së, Bordi Ankesave për Media ("Bordi") mund të dëgjojë dhe vendos për ankesat e palëve që drejtpërdrejt i nënshtrohen vendimit për sa i përket:

*dhënies, refuzimit, mos ripërtirjes ose revokimit të lejes transmetuese;
vëmjes ose ndryshimit të kushteve të lejes së transmetimit me përjashtim të kushteve që kanë të bëjnë me caktimin e frekuencave apo kritereve të tjera teknike;
shqiptimit të sanksioneve; dhe
çështjeve tjera të ngjashëm që mbështet në urdhëresat administrative dhe rregullore.*

23. Neni 25.1 i Ligjit të KPM-së, kërkon që ankesat t'i parashtrohen bordit të ankesave brenda 30 ditësh nga nxjerrja e vendimit. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohej nga bordi i ankesave në pajtim me nenin 24. 2 (a) të Ligjit të KPM-së.
24. Bordi gjithashtu ka përcaktuar rregullat e tij të procedurës të cilat janë në dispozicion nga zyra e Shefit ekzekutiv të KPM-së, sipas kërkesës së palës.
25. Neni 25.2 i Ligjit të KPM-së, thekson: *Bordi i Ankesave për Media do t'i merr parasysht vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të Këshillit, apo të bazuara në mundësinë e ekzistencës së gabim procedural dhe material i bërë nga ana e Këshillit gjatë marrjes së vendimit.*


Lëshimi i Vendimit

Këshilli i KPM-së e lëshon këtë vendim


Filloreta Bytyçi
Kryesuese e Këshillit të KPM-së



15/12/2010
datë


Luan Latifi
U. D. i Shefit Ekzekutiv

Më këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.

15.12.2010
datë